

URDHËR
Nr. 551, datë 31.8.2021

**PËR MOSLICENCIMIN E SHOQATËS “TRANSMETUESE RADIOTELEVIZIVE
KABLLOR VALOR (RrTL)” NË ADMINISTRIMIN KOLEKTIV TË TË DREJTAVE NË
FUSHËN E PRODHUESVE DHE TË AUTORËVE TË AUDIOVIZUALITETIT,
ORGANIZATAT TRANSMETUESE “OSHMA”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, ‘Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to’”, të ndryshuar, kërkesës së shoqatës “Transmetuese radiotelevizive kabllor valor (RrTL)” nr. 3704 prot., datë 16.7.2021, “Për licencimin si agjenci e administrimit kolektiv, për kategorinë e të drejtave në fushën e prodhuesve dhe të autorëve të audiovizualitetit, organizatat transmetuese “OSHMA”, si dhe të legjislacionit në fuqi “Për organizatat jofitimprurëse”:

URDHËROJ:

1. Moslicencimin e shoqatës “Transmetuese radiotelevizive kabllor valor (RrTL)” në fushën e prodhuesve dhe të autorëve të audiovizualitetit, organizatat transmetuese “OSHMA”.
2. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.
3. Kundër këtij urdhri, kërkuesi ka të drejtën e ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti